

SHPLLJE PËR PRAKTIKANTË

Titulli: Praktikantë, pesë (5) pozita

Departamenti: Teknologjisë Informative dhe Sigurisë

Në kuadër të programit “Praktika profesionale me studentë” Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall konkurs për pranimin e pesë (5) praktikantëve, me kohë të caktuar për një periudhë deri më 12 muaj. Objektivi kryesor i këtij programi është që stafi profesional i BQK-së të ndaj përvojat me studentët të cilët do të kryejnë këtë praktikë. Programi i praktikës për studentë u mundëson lidhjen midis njohurive të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura. Ky program zgjatë deri më 12 muaj, varësisht nga interesimi dhe suksesi i kandidatëve dhe nuk nënkupton në asnjë mënyrë marrëdhënie formale pune me BQK-në.

Studentët do të angazhohen në kryerjen e detyrave të përditshme së bashku me stafin e Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Sigurisë, me ç’rast do të bëhet edhe bartja e përvojës së punës nga stafi i departamentet te praktikantët e angazhuar.

Njohuritë e kërkuara:

- Kandidatët duhet të jenë studentë në studime universitare në fushën e shkencave kompjuterike, FSHMN ose FIEK;
- Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe në punë ekipore;
- Kandidatët me njohuri të mira në fushën e teknologjisë se infomacionit kanë një përparësi;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim për “Programi i praktikës për studentë”;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për praktike në BQK;
- Lista e notave nga universiteti përkatës;
- Një letër referencë;
- Kopja e letërnjoftimit apo ndonjë dokumenti tjetër identifikues;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është deri më **16 korrik 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet në email adresën praktika@bqk-kos.org ose përmes zyrës së Arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formulari i aplikacionit mund të shkarkohet përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org